



PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE

IPA II – MË TEPËR STRATEGJI DHE MBIKËQYRJE

Autorë:

Dr. Malinka Ristevska Jordanova,
Redaktore dhe eksperte e lartë dhe

Aleksandar Jovanoski,
Ekspert i ri

Instituti Evropian për Politika (IEP) - Shkup
Antonie Grubisic 2/2,
1000 Shkup,
Republika e Maqedonisë

contact@epi.org.mk
www.epi.org.mk

Lansimi i IPA II

Rregullorja e BE-së për IPA II ishte miratuar më 11 mars 2014 dhe ka filluar me zbatim më 1 janar 2014¹. Më tepër detaje mbi rregullat e zbatimit janë përcaktuar në rregulloren e zbatimit që ishte miratuar më 2 maj 2014².

IPA II nuk dallohet shumë nga IPA I në kuptim të qëllimeve dhe buxhetit. Në fakt, ajo përputhet me realitetin e përmbytjes dhe dinamikën e procesit të zgjerimit.

Objektiva e përgjithshme e IPA II është definuar si:

“...mbështetje për vendet përdoruese që gjenden në Aneksin I për miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike të nevojshme për ato vende për të përputhur me vlerat e Unionit dhe vazhdimisht të përputhet me rregullat, standardet, politikat dhe praktikatat e Unionit me synim të anëtarësimit në Unionin³.

IPA II nuk dallohet shumë nga IPA I në kuptim të qëllimeve dhe buxhetit.

Vendet përdoruese të IPA II janë: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Islanda, Kosova⁴, Mali i Zi, Serbia, Turqia dhe Republika e Maqedonisë.

¹ Rregullorja (BE) Nr. 231/2014 e 11 marsit 2014 për themelimin e Instrumentit të Ndhmës për Para Aderim (IPA II). Ndonëse miratuar vetëm në mars 2014, rregullorja vlen prej 1.1.2014

² Rregullorja e Komisionit për Zbatim (BE) Nr 447/2014 e 2 majit 2014 në rregullat specifike për zbatimin e rregullores (BE) Nr 231/2014 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit për themelimin e Instrumentit të Ndhmës për Para Aderim (IPA II)

³ Neni 1 i Rregullores IPA II.

⁴ Ky përcaktim është pa paragjykim për pozitën mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe mendimin e OJC për deklarimin e pavarësisë së Kosovës.

Në mungesë të ndonjë ndryshimi të madh të ndihmës për vendet candidate, theksohet që **“ndihma e para aderimit do të ndërlihet ngushtë me prioritetet e zgjerimit dhe do të bazohet në një qasje të orientuar drejt rezultateve dhe me një qasje strategjike që synon reforma kryesore në vendet e zgjerimit”⁵.**

Ndihma e para aderimit do të ndërlihet ngushtë me prioritetet e zgjerimit dhe do të bazohet në një qasje të orientuar drejt rezultateve dhe me një qasje strategjike që synon reforma kryesore në vendet e zgjerimit

Modifikimet kryesore që prezantohen me IPA II janë këto:

- Fusha politika në vend të komponentëve;
- Qasje sektoriale, të bazuar në përputhje me strategjitë kombëtare;
- Më tepër fokus në programim shumë vjetor;
- Orientim drejt rezultateve/performancës;
- Më tepër fleksibilitet- ri-alokim të mundshëm të fondeve varësisht nga performanca;
- Këshillim i thjeshtësuar i procedurave të menaxhimit.

IFokusi i IPA mbetet në **“çështjet e përgjithshme të zhvillimit socio-ekonomik dhe qeverisje e drejtë, në vend të trajtimit të kërkesave të komplikuara dhe më pak teknike të së drejtës evropiane”⁶.**

Qasja e re IPA kërkon një përputhje të nivelit të lartë me prioritetet kryesore të reformave (fokusimi në fushat e demokracisë dhe sundimi i të drejtës) siç është përcaktuar nga Strategjia për Zgjerim e BE-së për 2014-2015. Përveç kësaj, IPA II ka lidhje të fuqishme me dy dokumentet kryesore strategjike që kanë ndikim të drejtpërdrejtë me procesin e

⁵ Raport nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshilli dhe Komisioni Evropian Ekonomik dhe Social, Raporti Vjetor 2013 për Ndihmën Financiare për Zgjerim (IPA, PHARE, CARDS, Instrumenti i Para Aderimit për Turqinë, Lehtësimi për tranzicion) Bruksel, 30.9.2014 COM(2014) 610 final, {SWD(2014) 287 final}.

⁶ Koeth, W., The New Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA II): Less Accession, More Assistance? Instituti Evropian për Administratë Publike, Dokument Pune 2014/W/01.

reformave në rajon - Agjenda Evropë 2020⁷ dhe Strategjia e Evropës Juglindore 2020⁸.

Portofoli financiar

Për periudhën 2007-2013 IPA ka një buxhet prej € 11.5 miliard. Buxheti i IPA II është pothuaj njësoj - € 11.7 miliard për periudhën 2014-2020⁹.

Fondet e alokuar për periudhën 2014-2020 për përdorues janë prezantuar në Tabelën 1.

Tabela 1. Alokimi për IPA II për shtet përdorues në vit/s (në milion EUR)

	2014	2015	2016	2017	2018-2020	Gjithsej 2014-2020
Shqipëria	83,7	86,9	89,7	92,9	296,3	649,5
Bosnja dhe Hercegovina ¹⁰						
Kosova*	83,8	85,9	88,7	91,9	295,3	645,6
Maqedonia	85,7	88,9	91,6	94,9	303,1	664,2
Mali i Zi	39,5	35,6	37,5	39,6	118,5	270,7
Serbia	195,1	201,4	207,9	215,4	688,2	1508
Turqia	620,4	626,4	630,8	636,4	1.940,00	4.454,00
Gjithsej						8.192,00

Burim: Dokumenti Strategjik Indikativ i vendeve për përdorues, të miratuar në gusht 2014

* Ky përcaktim është pa paragjykim për pozitën mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe mendimin e OJC për deklarimin e pavarësisë së Kosovës.

⁷ http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

⁸ <http://www.rcc.int/pubs/20/south-east-europe-2020-strategy>

⁹ EUR 11 698 668 000 me çmime momentale, sipas rregullores për IPA II.

¹⁰ Dokumenti Strategjik Indikativ i Vendit për Bosnjë dhe Hercegovinë nuk është miratuar akoma.

Fondet për programin shumë-përdorues horizontal (programe rajonale) janë alokuar siç prezantuar në Tabelën 2.

Tabela 2: Alokimi i IPA II për programin shumë-përdorues për vit/s (në milion EUR)

	2014	2015	2016	2017	2018-20	Gjithsej 2014-20
A. Mbështetje horizontale	152	122,5	136,5	115,5	395,5	922
TAIEK dhe statistikë	20	21	20	21	59	141
Funksione këshillimore të organizatave ndërkombëtare	49	40	25	32	91	237
Shoqëria civile dhe medie	25	5	30	5	60	125
Erasmus+ përfshirë edhe dimensionin e të rinjve	33	34	35	35	110	247
Masat horizontale	25	22,5	26,5	22,5	75,5	172
B. Struktura rajonale dhe rrjete	9	27	31	10	57,5	134,5
C. Mbështetje për investime rajonale*	158,1	181,9	177,9	216,3	772,8	1506,9
WBIF, EDIF, GGF dhe instrumente tjera të shkrira	148,1	91,9	177,9	216,3	772,8	1406,9
Programi Rajonal për Strehim (PRS)	10	90	0	0	0	100
D. Bashkëpunimi territorial	28,9	33,6	44,6	68,6	219,5	395,2
GJITHSEJ	348	365	390	410,4	1445,3	2958,6

Burim: Dokumenti strategjik indikativ (2014-2020) miratuar më 30/06/2014

Fushat politike dhe qasja sektoriale

Nën IPA II, pesë komponentët e gjeneratës paraprake të IPA (IPA 2007 – 2013) janë braktisur, duke dhënë gjithë përdoruesve të IPA, pa dallim nga statusi, qasje të barabartë në IPA komponentin. Në vend të komponentëve, ndihma do të përqendrohet në fushat politike më poshtë:

- a) Reforma në përgatitjen për anëtarësim dhe ngritjen e kapaciteteve të institucioneve përkatëse;
- b) Zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal;
- c) Punësim, politika sociale, arsim, promovim të barazisë gjinore dhe zhvillimin e resurseve njerëzore;
- d) Bujqësi dhe zhvillimi rural;
- e) Bashkëpunimi rajonal dhe territorial.

Kriteret kryesore për të përcaktuar një sektor janë këto më poshtë:

- Lidhja me agjendën për hyrje në BE dhe/ose zhvillimi socio-ekonomik i vendit,
- Mjaft i gjerë për të qenë i rëndësishëm për procesin e aderimit me anë të indikatorëve matës, por edhe mjaft e ngushtë për të siguruar koherencën institucionale,
- Kornizë të qartë institucionale, menaxhim institucional dhe autoritet – idealist, sektori ka një autoritet menaxhimi,
- Lidhje të qartë me proceset buxhetore nacionale.

Sektorë indikativ në fusha politike janë dhënë në Tabelën 3¹¹.

Tabela 3. Lista indikative e sektorëve në fusha politike

Fusha politike	Sektori
a) Reforma në përgatitjen për anëtarësim në Union dhe ngritje të kapaciteteve të institucioneve dhe organizatave;	- Reforma në administratën publike - Qeverisje publike financiare - Drejtësi dhe punë të brendshme - Të drejta të njeriut dhe minoritete
b) Zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal;	- Transport - Energji - Mjedis jetësor - Zhvillimi i sektorit privat - Konkurrencë dhe inovacion
c) Punësim, politika sociale, arsim, promovim të barazisë gjinore dhe zhvillimi i resurseve njerëzore;	- Arsime dhe zhvillimi i resurseve njerëzore - Tregu i punës dhe punësimi - Politikë sociale
d) Bujqësi dhe zhvillim rural;	- Bujqësi - Zhvillim rural
e) Bashkëpunimi rajonal dhe territorial.	- Bashkëpunimi rajonal - Bashkëpunimi territorial

¹¹ Sektorët janë indikativë dhe mund të dallojnë prej varësisht nga përdoruesi.

Tabela më poshtë tregon alokimin e IPA II për fusha politike për gjithë përdoruesit e IPA-s.

Tabela 4: Alokimi i IPA II për fushë politike (në milion EUR)

	a. Reforma në përgatitje për anëtarësim në Union dhe ngritje të kapaciteteve të institucioneve dhe organizatave	b. Zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal	c. Punësim, politika sociale, arsim, promovim të barazisë gjinore dhe zhvillimi i resurseve njerëzore	d. Bashkëpunimi rajonal dhe territorial	GJITHSEJ 2014-2020
Shqipëria	320,5	168,0	69,0	92,0	649,4
Kosova*	236,6	235,0	94,2	79,7	645,5
Maqedonia	205,9	298,8	53,2	106,3	664,2
Mali i Zi	99,2	90,8	28,1	52,4	270,5
Serbia	543,0	565,0	190,0	210,0	1.508,0
Turqia	1.581,4	1.525,3	1.525,3	912,2	4.453,9
GJITHSEJ	2986,6	2882,9	1959,8	1452,6	8191,5

Burim: Dokumenti strategjik i vendit që gjendet në listë

Qasja e sektorit përbëhet nga ndarja e ndihmës së BE-së në një numër më të vogël të sektorëve strategjik që janë identifikuar bashkërisht nga BE-ja dhe vendet përdoruese, duke pasur parasysh strategjitë nacionale si udhëzues kryesor për programim)¹².

Qasja sektoriale ka për synim të prodhojë një përputhje më të afërt mes BE-së dhe strategjive nacionale dhe një shkallë më të lartë të pronësisë të vendeve përdorues. Parimi i pronësisë është thelbësor për të arritur rezultate të kuptimtare që jo vetëm plotësojnë kritere specifike (si hartimi i strategjive dhe ligjeve) por kanë ndikim të vërtetë mbi vendin (për shkak të pranimit të tyre dhe zbatimit përkatës).

Një nga rezultatet kryesore të vlerësimit të bërë për Komisionin Evropian

* Ky përcaktim është pa paragjykim për pozitën mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe mendimin e OJÇ për deklarimin e pavarësisë së Kosovës.

¹² Definicioni zyrtar i KE-së për qasje sektoriale -documents/europeaid_adm_guidelines_support_to_sector_prog_sep07_short_en.pdf

ishte se “mbajtja e rezultateve dhe ndikimet e arritura nga IPA mbështeten në prioritetet politike në nivel kombëtar”, dhe se “aty ku pronësia kombëtare e reformave të propozuara është më e ulët ndikimi është i zvogëluar”¹³. Rrjedhimisht, pronësia kombëtare është një nga arritjet më të mëdha në IPA II, kërkon nivel të lartë të konvergencës ndërmjet prioritetëve kombëtare dhe agjendën e BE. Një argument i madh është se anëtarësimi në BE shihet si një prioritet kombëtar strategjik nga ana e përdoruesve dhe që të gjitha masat që synojnë përmbushjen e standardeve të BE-së në mënyrë automatike duhet të vendosen si prioritetet strategjike kombëtare. Megjithatë, kjo do të paraqet një sfidë, sidomos duke pasur parasysh sektorët prioritarë të demokracisë dhe sundimit të ligjit, ku në çështje të ndjeshme prioritetet politike mund të devijojë nga objektivat e asistencës së IPA-së.

Deri në fund të IPA I, Komisioni në bashkëpunim me aktorët kombëtar dhe aktorët e BE-së e kuptoi se metodologjia më parë e parashikuar për zbatimin e IPA nëpërmjet projekteve të veçanta që mbulojnë një shumëllojshmëri të prioritetëve të fragmentuara nuk jep rezultatet e pritura, duke u fokusuar më shumë në rezultate të menjëhershme (p.sh. kompjuterizimi i sistemit për menaxhimin e rasteve në gjykata), dhe jo në arritjen e objektivave të politikave (p.sh.), funksionimi më i mirë i sistemit të drejtësisë nëpërmjet uljes së numrit të madh të rasteve të grumbulluara gjyqësore, si ndikim i sistemit të menaxhimit të rasteve)¹⁴. Lidhja e pamjaftueshme me dokumentet e politikave nacionale është perceptuar si një disavantazh të madh. Një prej sfidave më të mëdha të IPA II do të jetë kapërcimi i kësaj mangësie duke krijuar lidhje më të forta mes planifikimit strategjik, zbatimit e IPA-s dhe më e rëndësishmja, arritjen e nivelit të lartë të ndikimit në rezultatin e proceseve të reformave.

Analiza e Komisionit tregoi se, “shumica e projekteve janë marrë me problemet specifike dhe janë përgatitur nga grupe të vogla specialistësh në institucionet qeveritare; kjo shpesh ka rezultuar në pronësi të dobët institucionale për shkak se shumë pak përpjekje janë bërë për të përfshirë një komunitet më të gjerë të ekspertëve dhe për të treguar rëndësinë e projekteve të agjendave të politikës kombëtare”¹⁵. Kështu, parimi i partneritetit do të jetë një faktor kyç për programimin dhe zbatimin e suksesshëm të IPA II.

¹³ IPA - vlerësim i përkohshëm dhe meta vlerësim i IPA asistencës, Ecorys, shtator 2013.

¹⁴ Dokument udhëzues i DP për zgjerim: “Qasja sektoriale në asistencën para-aderuese”, 18/01/2013, Ref. Ares(2013)65573

¹⁵ Ibid.

Kuadri i Përbashkët Strategjik do të jetë dokumenti strategjik i programimit i BE-së për instrumentin si një tërësi - për të gjitha vendet e përfshira. Dokumentet strategjike të vendit (DSV) janë dokumentet kryesore shumë-vjetore që përshkruajnë në përgjithësi se si vendet përdoruese do të përdorin ndihmën financiare për tu marrë me prioritetet politike të strategjisë së zgjerimit. Pas miratimit të DSV-ve, programet do të zhvillohen. Në mënyrë të ngjashme, një Dokument Strategjik për më Shumë Vende (DSSHV) përcakton prioritetet dhe kushtet për arritjen e programeve me më shumë-përdorues në nivel rajonal dhe për programet e bashkëpunimit territorial.

DSV gjithashtu përfshin edhe shpërndarjet paraprake financiare për vitin dhe do të mbetet i vlefshëm deri në vitin 2020 (me vetëm një rishikim afatmesëm në 2017). Për këtë shkak, çështja e programimit dhe miratimit të programeve sektoriale me cilësi të lartë do të ketë një efekt të drejtpërdrejtë në absorbimin përfundimtar të fondeve të shpërndara.

Sipas rregullores së re, Dokumentet Strategjike të Vendit (DSV) janë hartuar për të skicuar fushat kryesore ku përmirësimet substanciale janë të nevojshme për përgatitjen e vendit për anëtarësim. Këto dokumente duhet të **“përcaktojnë objektivat e ndërlidhura me asistencë, qasjen për të përmbushur ato si dhe mjetet dhe treguesit për matjen e progresit dhe të arriturat”**¹⁶.

Rregullorja IPA II në veçanti nënvizon se progresi do të vlerësohet me anë të treguesve të përcaktuar më parë. Në bazë të përparimit, KE do të ketë autorizim për të ri-alokuar ndihmë financiare në mes të programeve të ndryshme, si dhe në mes të përdoruesve të IPA-së.

Qasje e re për dorëzimin e menaxhimit tek përdoruesit

Nga ana e Komisionit menaxhimi i asistencës për komponentët e mëparshëm do të jetë i efektshëm nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme (DP) për Zgjerim. Kjo zgjidhje do të mbetet në fuqi deri në

¹⁶ Ibid.

fazë të mëvonshme në procesin e pranimit, ku Drejtoritë përkatëse do të përfshihen (me afrimin e vendit kandidat kah anëtarësimi).

Në IPA I, delegimi i menaxhimit të fondeve të para-pranimit shiheshin si përgatitje për vendet candidate për zbatimin e mekanizmave të kërkuara nga të gjitha Shtetet Anëtare në menaxhimin e fondeve të BE-së, në veçanti për komponentët III-V, që pasqyrohet në instrumentet e strukturore dhe politikat e kohezionit të BE-së, dhe Politika e Përbashkët Bujqësore.

Qasja e IPA II në menaxhimin e asistencës financiare është përshkruar si:

“qasje më progresive, e përqendruar në faza”, me “më pak procese për akreditim dhe dhënie të kompetencave të menaxhimit” të parapara për “ulje të koston dhe barrës së koordinimit të shkaktuara nga “vendet përdoruese”¹⁷.

Fakti që “jo vetëm kriteret e akreditimit për vendet candidate janë lehtësuar, por edhe rregulla tjera zbatuese janë harmonizuar me ato që zbatohen për vendet në zhvillim, duke u larguar nga metodologjia e kaluar: përgatitja e vendeve candidate për menaxhimin financiar të fondeve strukturore të BE-së pas aderimit nuk paraqitet si prioritet në rregulloren IPA II”¹⁸.

Prioritetet e përcaktuara në Dokumentet Strategjike të Vedit nuk duhet të ndryshojnë me kalimin e kohës (nëse nuk ndryshon aqis).

Programi vjetor (siç ishte rasti me Komponentin I nga IPA I) duhet të zëvendësohet me programim shumë-vjetor.

¹⁷ Propozim për rregullim të Instrumentit për Asistencë Para-aderuese (IPA II) e 7.12.2011 COM(2011) 838 final

¹⁸ Koeth, W., The New Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA II): Less Accession, More Assistance? Instituti evropian për administratë publike, Dokument pune 2014/W/01.

Roli i rritur i parlamenteve kombëtare – paradigme që lëviz në shqyrtim

IPA II vendos më shumë theks mbi parimin partneritetit dhe rolin e parlamenteve.

Rregullorja obligon Komisionin, “parimisht, të vepron në partneritet me përdoruesit, gjatë përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të asistencës”, duke shpjeguar se partneriteti duhet të përfshijë:

“përshtatshëm, autoritetet kompetente kombëtare dhe lokale, si dhe organizatat e shoqërisë civile”. Përveç kësaj, “koordinimi mes palëve të interesuara”, duhet të inkurajohet nga Komisioni. Për më tepër, organizatat e shoqërisë civile mund të jenë përdorues të drejtpërdrejtë të ndihmës¹⁹.

Kur këto dispozita lexohen së bashku me dispozitat mbi Parimin e pronësisë në Rregulloren Implementuese IPA II²⁰, është e qartë se partneriteti në nivel kombëtar i përdoruesve inkurajuar fuqimisht.

Rregullorja IPA II në mënyrë eksplicite inkurajon mbikëqyrjen parlamentare në vendet përdoruese²¹.

Në përgjithësi, parlamentet në rajon posedojnë mekanizma të mjaftueshëm për të zhvilluar fuqitë shqyrtuese mbi përdorimin e fondeve të Be-së. Sidoqoftë, mekanizmat ekzistues nuk janë shfrytëzuar deri në potencialin maksimal; kështu që shqyrtimi i parlamentit mbi qeverinë për programet financiare të BE-së është i dobët, i pa-strukturuar dhe sporadik.

¹⁹ IPA II Rregullorja, Neni 4, Par 6.

²⁰ IPA II Rregullorja zbatuese, Neni. 4.

²¹ IPA II Rregullorja, Hyrje, f. (15).

Prandaj, parlamentet kombëtare (sidomos Komisionet për çështje evropiane) kanë një rol kyç për të luajtur në programimin dhe monitorimin e IPA II - që të arrihet pronësia 'lokale' dhe të mundësojnë shqyrtim efektiv mbi absorbim e fondeve të BE-së.

Në pjesën më të madhe të parlamenteve kombëtare në nivel të bashkimit Evropian, Komisionet për çështje evropiane kanë rol qëndror në sigurimin e procedurave të shqyrtimit. Sidoqoftë, varësisht prej praktikave parlamentare, një numër i komisioneve sektoriale të parlamenteve gjithashtu marrin pjesë në procesin e shqyrtimit.

Praktikat e IPA përdoruesve tregojnë mungesën e angazhimit të parlamentit në pothuajse të gjitha fazat e implementimit të IPA-s, duke përfshirë programimin e IPA-s. Kjo mundësi u humb gjatë 2013-2014, kur u hartuan Dokumentet Strategjike të Vendit.

“Në përputhje me parimin e demokracisë pjesëmarrëse, mbikëqyrja parlamentare për çdo përdorues të listuar në Aneksin I të asistencës së dhënë për atë përdorues duhet të inkurajohet nga Komisioni”.

Parlamenti maqedonas dha një shembull pozitiv në mbajtjen e seancë së parë të plotë parlamentare për absorbimin e IPA-s në vitin 2013. Megjithatë, mundësia për më shumë ndikim në procesin e programimit IPA II - Dokumenti Strategjik Indikativ i Vendit 2014-2020 nuk u përfshi. Organizatat e shoqërisë civile siguruan shembull pozitiv duke dhënë kontribut të strukturuar në Dokumentin Strategjik të Vendit²².

Me rritjen e dukshmërisë së IPA-së për qytetarët si një përpjekje teknokratike, dhe jo një instrument i vërtetë për reforma që sjell përfitime për qytetarët dhe shoqërinë në përgjithësi, deputetët e të informuar dhe angazhuar mund të luajnë rol më të fuqishëm në ndryshimin e këtij perceptimi. Për më tepër, pasi kapacitetet e parlamenteve nuk lejojnë analizë të pavarur të fondeve të IPA-s, duhet të përdoret në masë maksimale burimet në dispozicion në kuadër të shoqërisë civile.

²² Një rrjetë i organizatave në vijim: Eko-svest, Instituti Evropian për Politika, Think tank Analitika, Qendra Maqedonase për Trajnim evropian, Zenit, Front 24/12 dhe Qendra për komunikime Civile organizuan një ngjarje ku morën pjesë mbi 100 OJQ dhe dhanë kontribut në Dokumentin Strategjik të Vendit.

Opsionet e politikave për parlamentet

Bazuar në leksionet e mësuara nga IPA I (2007-2013), mund të merren disa hapa nga parlamentet kombëtare të përdoruesve të IPA-së për të përmirësuar shqyrtimin e tyre të IPA II²³:

- Kërkojnë raporte të strukturuar për zbatimin e secilës politikë sektoriale nga autoritetet kombëtare, duke përfshirë edhe raportin mbi përmbushjen e treguesve të suksesit të listuar si aneks në çdo Dokument Strategjik të Vendit nën IPA II; Këto raporte duhet të përbajnë edhe informata mbi kontraktimin;

- Përfshihen në diskutim për çështjet strategjike në lidhje me fondet e BE-së, veçanërisht në prioritetet nën çdo politikë sektoriale - shqyrtim mbi dokumentet sektoriale strategjike të përcaktuara nga Dokumenti Strategjik kombëtar i Vendit;

- Të kontribuojnë në thelb në zbatimin e parimit të pronësisë dhe partneritetit në zbatim të IPA fondeve dhe të përfshijë aktorët në programimin dhe implementimin e IPA-s;

- Mbajnë seanca publike mbi IPA-n, përfshirë ato tematike, të përkushtuara secilës fushë/ sektor të politikave;

- Rritje e nivelit të pjesëmarrjes së aktorëve me përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile, akademisë, biznesit, dhomave të tregtisë, shoqatave profesionale, etj.;

- Forcim i rolit të Komisioneve për Buxhet dhe Financa, që gjithashtu duhet të kenë shqyrtim në sigurimin e bashkë-financimit të IPA II në Buxhetin e Shtetit,

- Rritje të kapaciteteve administrative të stafit që punon në IPA;

- Zhvillim i platformës rajonale për vëzhgim të IPA, duke kontribuar në mbikëqyrje të përmirësuar dhe shpërndarje të praktikave më të mira.

Parlamentet kombëtare (në veçanti Komisionet për çështje evropiane) kanë rol kyç në programimin dhe vëzhgimin e IPA II – që të arrihet pronësia “lokale”.

²³ Prezantime më të detajuara në: Instrumenti për Para-Aderim dhe Mbikëqyrja e tij Parlamentare, Udhëzues për Anëtarët e Parlamentit dhe Stafin Parlamentar, Westminster Fondacioni për Demokraci, tetor 2013.

Ky publikim është i përpiluar me përkrahjen
e Westminster Fondacionit për Demokraci